

KLARA KODRA

ROMANI “KARPA” DHE CAMAJ SI LËVRUES I LLOJIT FANTASTIKO-SHKENCOR

Romanet e Camajt dallohen për *veçanësi* si në kuadrin e krijimtarisë së vetë autorit ashtu edhe në kuadrin e romanit shqiptar.

Megjithatë çuditërisht tipologjia e këtyre romaneve dhe vlera e tyre estetike kanë mbetur pothuajse jashtë vëmendjes së studiuesve.

Për romanin “Rrathët” ka pasur një mendim në shkencën letrare për ta klasifikuar si “roman psikologjik”, madje “i pari roman psikologjik i letërsisë shqipe”¹. Duke pranuar, me ndonjë rezervë këtë përkufizim, mund ta plotësojmë me një përkufizim tjetër, “simbolist”.

Romani “Karpa”, i botuar më 1987, ka pasur fatin më të keq ndër romanet e Camajt meqenëse për atë pothuajse është heshtur. Nuk dihen shkaqet e kësaj heshtjeje të studiuesve që, për mendimin tonë, nuk përlligjet me ndonjë vlerë më të paktë estetike të romanit në fjalë.

Meqenëse ngjarjet e këtij romani janë projektuar në të ardhmen, do të mund ta përfshinim në llojin fantastiko-shkencor, tepër të përhapur në letërsinë botërore të shekullit të njëzetë dhe të lindur tepër vonë në letërsinë shqiptare. Mund të flitet edhe për elemente të romanit utopist, paraardhësit të tij që në Shqipëri nuk u zhvillua.

Ngjarjet e romanit të Camajt janë të vendosura në Shqipëri, madje buzë lumit Drin. Këtu ky roman afrohet me prirjen e pranishme në romanet fantastiko-shkencore të lindura gjatë kohës së diktaturës në atdheun e tij, për t’i inkuadruar subjektet në një kornizë shqiptare. Megjithatë vepra në fjalë ndryshon së tepërmi prej këtyre romaneve ku elementet teknike dhe shkencore zenë një vend tepër të madh, duke minimizuar rolin e personazheve në to, ku vlera estetike arrihet rrallë dhe ideologjizimi hedh hijen e vet të theksuar.

Romani i Camajt dallon edhe nga romanet fantastiko-shkencore të lindura në Francë, Itali, Angli apo Gjermani, ka një frymë të vetën, shqiptare.

Është fjala për një vepër vërtet artistike dhe madje me karakter elitar e cila e përmbush plotësisht thënien që gjejmë në një revistë italiane

¹ R. Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997, f. 481.

kushtuar llojit fantastiko-shkencor, “Futuro” (“E ardhmja”): “Lloji fantastiko-shkencor s’është një prodhim dytësor i letërsisë, po është krejtësisht letërsi”².

Është një vepër, pra, që karakterizohet nga literaliteti, jo një roman “i masës”.

Elementi shkencor këtu i nënshtrohet fantazisë krijuese dhe “vizionit të jetës” të autorit.

Në vepër hipotetizohet një katastrofë atomike e cila përkufizohet si “shtrëngatë e thatë” dhe jepet në retrospektivë. Katastrofa në fjalë e ka shkatërruar qytetërimin e sotëm dhe është bërë shkak për lindjen e një cikli tjetër në historinë e njerëzimit.

Shoqëria që vihet në qendër të romanit është një shoqëri patriarkale e mbajtur në këmbë nga barinjte dhe bujqit. Autori sikur realizon këtu thënien e Frommit: “...ndryshimi ndërmjet intelektit teknik dhe logjikës do e çojë botën drejt luftës atomike. Përfundimi më i mundshëm i një lufte të tillë do të jetë fundi i civilizimit industrial dhe kthimi i botës mbrapsht në nivelin agrar primitiv”³.

Megjithatë në bazë të kësaj shoqërie qëndron një lloj diktature me një prijës të vetëm autokrat që emërtohet si “Gjyshi” ose “Patriarku”. Bëhet fjalë gjithashtu për një lloj të ri matriarkati.

Më vonë diktatura merr fund me vrasjen e diktatorit dhe shpërthen lufta civile nga e cila lind një shoqëri e re, po aspak ideale. Duket se në roman ka aluzione për diktaturën komuniste dhe udhëheqësin e saj.

Romani “Karpa” është strukturuar në formë kornize, në të vihet re një “fiction” brenda “fictionit” (kronika – roman që zë qendrën e veprës me dy pjesët e saj). Këtë tablo të një realiteti të imagjinuar e ngërthejnë dhe e rrethojnë “kuadri i parë” që e nis romanin dhe “kuadri i dytë” që e mbyll.

Kronika – roman nuk mishëron vetëm një realitet imagjinar, po edhe një realitet virtual për të cilin bëhet një përpjekje që të mos realizohet në të ardhmen siç duket në këshillën që i jep Shkriba Vonit, protagonistit, për të ikur para se të bëhet martesë.

Mospranimi i tij shpreh besnikërinë ndaj fjalës së dhënë, po edhe një lloj sfide apo nënshtrim ndaj fatit.

Në të vërtetë vepra përbëhet nga dy romane brenda një romani dhe ndofta më i qarti është ai që jepet si fryt i fantazisë ku karakterizimi i personazheve është më i theksuar.

² *Scrittore e lettore nella società di massa*, Edizioni Lint Trieste, 1991, f. 289.

³ E. Fromm, *Psikoanaliza, seksi dhe karakteri*, Sh.B.Fan Noli, Tiranë, f. 105.

Dy romanet bashkohen nëpërmjet protagonistit, Vonit, dhe Borës, vajzës që ai dashuron, si edhe nëpërmjet personazhesh të tjera, më pak të individualizuara, me role të ndryshme.

Një dukuri interesante në vepër është dhënia e personazheve në dy variante: secili prej tyre ka sozinë e vet imagjinare.

Në “kronikën” që është “roman brenda romanit” protagonistit dhe e dashura e tij dalin si personazhe më të plota. Prandaj do të ndalemi te ky karakterizim i tyre. Protagonisti nuk është as heroi tradicional i romanit, bartës i idealeve të autorit, as “njeriu pa cilësi”, “njeriu valë” tipik për romanin modernist, po është megjithatë një njeri që ruan individualitetin e vet, një lloj anarkisti dhe pacifisti që i kundërvihet trysnisë së shoqërisë mbi individin dhe disa dukurive që i quan të gabuara si martesë me përdhunë ose lufta (që në rastin konkret është luftë civile), është i aftë për qëndrim të guximshëm, edhe për dashuri si dëshmon ndjenja e tij për Borën, beson te shkenca e te puna e njeriut siç tregojnë kërkimet e tij në fushën e helmeve, është i lidhur me traditën si dëshmon zbulimi nga ana e tij e një cope të Ilirisë.

Shoqëria paraqitet si antagoniste e tij, ajo e flak dy herë duke e vënë në rrezik vdekjeje, po protagonistit arrin t’i mbijetojë luftës së vet individuale, madje të realizojë ëndrrën e vet të dashurisë, ndonëse më vonë zhgënjehet prej saj dhe përjeton një dashuri tjetër.

Gjyshi që në romanin-kronikë mishëron diktatorin, çuditërisht s’është një figurë krejt negative (ndonëse karakterizohet prej një personazhi tjetër si njeri të cilit “logjika e ndija ... i janë thjeshtësue ... në shëmbëllesë të një tablo pikturë së cilës i asht shkoqë ngjyra leskra leskra dhe i ka mbetë sall vizatimi me pak përvija); ai, sipas autorit, e ruan trimërinë tradicionale shqiptare. Populli mban ndaj tij një qëndrim ambivalent prej dashurie/urrejtjeje (po duket se në fund mbizotëron urrejtja, meqenëse autori i atribuon një fund tragjik, vdekjen nga helmi bashkë me rrethin e vet të plakave që e ruanin). Duket qartë se autori ka dashur të aludojë për diktatorin real të Shqipërisë, ndonëse e ndryshon përmes fantazisë fatin e tij.

Aluzione të ndryshme për diktaturën komuniste (që transplantohet në një kohë të ardhme të largët) janë të shpërndara në tërë romanin: të tilla janë përshkrimi i dukurive të tilla si gjimnastika e mëngjesit apo ndalimi i televizorëve, burgosja e kundërshtarëve të regjimit në Kopshtin Zoologjik.

Në roman jepet një lloj matriarkati i ri i çuditshëm që ironizohet. Mendojmë se ky ironizim shpreh shqetësimin e Camajt për zhdukjen e veçorive femërore të gratë shqiptare në kohën e diktaturës. Aty këtu nëpërmjet dialogjeve të personazheve shfaqet hapur qëndrimi i autorit: “... skeleti anatomik i Gjyshit (pra, diktatorit) me një cipë të hollë lëkure

përsipër shëmbëllen vorfninë shpirtnore tonë, burgun moral të një shoqnie pa perspektivë” pohon Shkriba dhe pyetjes së Vonit “Çka e mban në kambë këtë sistem?” i përgjigjet hapur “Terrori, skeleti i Plakut!”

Kuptimplote janë gjithashtu fraza e Shkribës “Edhe sot ata që kundrojnë katundin tonë për së largu kujtojnë se kanë parasysh një qytet të përparuem me pallate, bile!” dhe përgjigja e Gjyshit “Le t’u duken ashtu që të na e kenë frikën e të na lanë në punë tonë!”

Personazh me interes në vepër është edhe Shkriba që në kronikë paraqitet si figurë kontradiktore, e urren diktaturën dhe diktatorin, po shkruan për ta një kronikë të re me.

Një personazh që tërheq vëmendjen është edhe Arbëreshi i cili kthehet në atdheun e origjinës për shkak të mallit për traditën dhe për t’iu kundërvënë xhaxhait të tij që kishte ëndërruar për një emigracion të dytë në Amerikë. Fati i tij është dramatik, diktatura e mbyll në Kopshtin Zoologjik. Karakteristikë është që ai jepet si poet ose eseist.

Mund të përmendim gjithashtu për veçanësinë e tyre figura grash si amazona në thelb negative, Ajka, që mbështet diktatorin, e bija, Bora/Judita, e kundërt me të, e bukur, delikate, e guximshme, e mençur, Lejda, po aq e bukur dhe e mençur, po që kryen një gabim tragjik me dashurinë e saj fajtojnë për Vonin.

Personazhet realë në roman janë si një shëmbëlltyrë e zbetë e personazheve të kronikës së fantazuar. Voni e ruan frymën rebele, zellin për punë dhe ndjenjën e dashurisë, po paraqitet edhe si ithtar i besës tradicionale dhe konflikti i tij me shoqërinë nuk çohet deri në fund.

Bora reale është vetëm një vajzë e bukur, e çiltër dhe naive, nuk ka kompleksitetin e Borës së kronikës, e dyzuar midis traditës dhe modernitetit siç e shprehin edhe dy emrat e saj, Bora dhe Judita dhe nuk përjeton fatin e hidhur të binjakes së vet imagjinare. Gjyshi në realitet s’jepet më si diktator, po thjesht si ëndërrimtar me teorinë e vet të çuditshme të rimishërimit.

Kronisti ose Shkriba që në kronikë ka një fund tragjik, në realitet shfaq kujdes për fatin e protagonistit.

Camaj, pra, ndonëse e ngarkon veprën e vet me simbole dhe alternon ëndërr dhe realitet nuk e zhduk, as e redukton subjektin dhe personazhet si modernistët. Nën veshjen fantastike madje mund të gjejmë edhe elemente të realizmit. Do të mund të flitej për një ndërthurje të simbolizmit dhe realizmit.

Një qenie simbolike në roman është kali që madje identifikohet me dragoin dhe njerëzohet.

Edhe protagonistit i atribuohet një veçori fizike që e afron me dragoin, dhëmbët e pazhvilluar.

Romani ka dialogje të gjalla që luajnë një rol të dyfishtë: karakterizimin e personazheve dhe bartjen e një ngarkese filologjike.

Stili i autorit dallohet nga mbizotërimi i frazave të gjata të stolisura me një figuracion poetik dhe me frymë popullore. Vepra e Camajt i përket asaj dege historike të llojit fantastiko-shkencor që është quajtur sociologjike apo “e ftohtë” ku nuk gjejmë entuziazmin dhe retorikën naive të degës së parë që kanë mbijetuar në vendet e Lindjes komuniste, duke përfshirë Shqipërinë. Te ky roman shkrihen kritika për të sotmen, ankthi për të ardhmen, nostalgjia për të kaluarën.

Ankthi për një katastrofë të mundshme atomike në fakt i përshkon shumë romane fantastiko-shkencore evropiane të kohës së “luftës së ftohtë”, po vepra e Camajt i takon një kohe më të vonshme, çka dëshmon se skepticizmi ndaj progresit të njerëzimit është gjithnjë i pranishëm tek ai dhe ai shqetësohet për humbjen e vlerave shpirtërore tradicionale dhe për marrëdhënien e gabuar të njeriut me natyrën.

Megjithatë mesazhi i veprës shpreh shqetësim, po jo dëshpërim, në të depërton një fill shprese.

Në roman ndeshim një temë që zinte shumë vend te poezia e Camajt, temën e *vetmisë*, vetmisë së individit në raport me shoqërinë, vetmi aq shoqërore sa ekzistenciale.

Edhe në prozën e kësaj vepre ka depërtuar poezia përmes ritualit të frazave dhe figuracionit shprehës.

Romani “Karpa” zë një vend të denjë në krijimtarinë prej romancieri të Camajt dhe mishëron një model të veçantë elitare të llojit fantastiko-shkencor që spikat për origjinalitet në kuadrin e letërsisë shqiptare dhe madje do të meritonte të vlerësohej në kuadrin e letërsisë evropiane.

BIBLIOGRAFIA

Anton Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*, Kozencë 1994

Martin Camaj, *Karpa*, Camaj – Pipa, Shkodër, 2003

Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997, f. 480-482.

Encyclopaedia universalis, France, S.A.1988, Corpus 16, f. 544-546.

Grande dizionario enciclopedico, UTET, Torino, 1968, v. 7, f. 535-536.

Nouvelle encyclopedie Bordas, Paris 1985, v. 9, f. 5009.

K. Petriti, *Në poetikën e Martin Camajt*, Tiranë, 1997.

KLARA KODRA

Scrittore e lettore nella società di massa, Edizioni Lint, Trieste, 1991, f. 289-311.

Primo Shllaku, *Nji Uliks që s'mbrriti kurr në Itakë*, Sh.B. At Gjergj Fishta, Lezhë, 2006.

Tradita dhe bashkëkohësia, Simpozium, Shkodër, 1994.